



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1055/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sadik Halitjaha kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Therandë paraqitur kundër Komisionerëve të Vendvotimeve, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe manipulimit të votave në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Sadik Halitjaha kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Therandë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Sadik Halitjaha kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga AAK në Therandë në të cilën pretendon se në votimet për asamblëstë në Therandë 03. Nëntor në Mushtisht vendvotimi 01 dëshmon se Brahim Alija me familje që e kanë votuar, në Grejkovc vendvotimi 01 dëshmon se e kanë votuar Gjemajl Beqiraj me vëllezer, në Budakovë vendvotimi 03 dëshmon se Muhamet Sallauka me familje e kanë votuar. Parashtruesi i ankesës dëshiron ti hapë këto kuti: Në Mushtisht 01, në Budakovë 03, në Grejkovc 01.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1055/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.